

ARRATISJA E MEHDI FRASHËRIT NGA TERRITORI I SHKODRËS: SHKAQET DHE PASOJA HISTORIKE

Msc Erta Boriçi
Specialiste AIDSSH

Abstrakt

Ky punim synon të analizojë në mënyrë të thelluar figurën komplekse të Mehdi Frashërit (1872–1963), një ndër përfaqësuesit më të rëndësishëm të elitës shqiptare të shekullit XX, në tre plane kryesore: shtet-formimi, mendimi politik, arratisja dhe trajtimi i figurës së tij në kujtesën historike. I arsimuar në shkollat elitare osmane dhe i përfshirë aktivisht në jetën politike të Shqipërisë së pavarur, Frashëri ishte një nga arkitektët e sistemit shtetëror shqiptar. Nëpërmjet analizës së burimeve arkivore, literaturës historiografike dhe veprave të tij personale, përfshirë kujtimet dhe botimet politike, punimi eksploron përpjekjet e tij për të ruajtur pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë gjatë pushtimeve të huaja, përballjen me regjimin komunist dhe rehabilitimin e tij pas viteve 1990. Në përfundim, figura e Mehdi Frashërit rishfaqet si një model i elitës reformuese shqiptare, me vlera demokratike dhe qëndrim kritik ndaj çdo forme totalitarizmi.

Fjalë kyçe: Mehdi Frashëri, elita shqiptare, shtet-formimi, mendimi politik, arratisja, kujtesa historike, pavarësia e Shqipërisë, pushtimet e huaja, regjimi totalitar komunist, rehabilitimi.

Qëllimi

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë në mënyrë të thelluar dhe të paanshme rrethanat, shkaqet dhe pasojat historike të arratisjes së Mehdi Frashërit nga territori i Shkodrës, duke e vendosur këtë ngjarje në kontekstin më të gjerë politik të Shqipërisë në fundin e Luftës së Dytë Botërore. Studimi synon të përcaktojë faktorët që e detyruan Frashërin të largohej nga vendi, rolin që pati klima e tensionuar politike e vitit 1944, si dhe pasojat e menjëhershme dhe afatgjata të kësaj arratisjeje për jetën e tij personale, për perceptimin publik të figurës së tij dhe për kujtesën historike shqiptare. Gjithashtu, objektivi kryesor mbetet vlerësimi kritik i mënyrës sesi kjo ngjarje është interpretuar ndër dekada, shpesh nën ndikimin e narrativave ideologjike dhe ofrimi i një qasjeje bashkëkohore që e trajton arratisjen e Frashërit si një akt politik të lidhur ngushtë me rrjedhat dramatike të kohës.

Hyrje

Arratisja e Mehdi Frashërit nga territori i Shkodrës përbën një episod të rëndësishëm dhe ende pak të studiuar në historinë politike shqiptare të shekullit XX. Ky moment, i ndodhur në një periudhë tensionesh të larta politike dhe lëvizjesh strategjike brenda elitave shqiptare, hedh dritë mbi marrëdhëniet e brishta mes individëve të pushtetit dhe realiteteve të një shteti në krizë. Ngjarja nuk ka rëndësi vetëm si akt i një personaliteti të njohur, por edhe si tregues i klimës së pasigurisë politike, përplasjes së ideologjive dhe mekanizmave të kontrollit, që karakterizonin Shqipërinë në atë kohë. Analizimi i arsyeve të arratisjes dhe i rrethanave që e prodhuan atë, na lejon të kuptojmë më thellë zhvillimet e brendshme politike, raportet mes elitave, si dhe mënyrën sesi individët e rëndësishëm manovronin përballë rrezikut, presioneve ose ndryshimeve drastike të pushtetit. Po ashtu, pasojat historike të këtij episodi ndihmojnë në ndriçimin e një faze kritike të historisë shqiptare, ku vendimet personale pasqyronin shpesh tensione të gjera kombëtare dhe rajonale. Në këtë kuadër, trajtimi i arratisjes së Mehdi Frashërit, nga Shkodra, krijon një dritare të vlefshme për të kuptuar jo vetëm fatin e tij politik, por edhe dinamikat e një periudhe ku mbijetesa politike ishte e lidhur ngushtë me lëvizje të guximshme dhe shpesh të rrezikshme.

Formimi dhe përvoja në Perandorinë Osmane.

Mehdi Frashëri u lind më 28 shkurt 1872 në Frashër, një qendër me tradita të forta patriotike dhe kulturore në jug të Shqipërisë, në një familje me lidhje të drejtpërdrejta me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Familja e tij, kishte dhënë figura të rëndësishme në politikën, administratën dhe kulturën shqiptare. Kjo trashëgimi shpirtërore dhe politike ndikoi që në moshë të re në formimin e tij si individ me ndërgjegje kombëtare dhe mision publik. Rruga e tij arsimore filloi në ambientet e Perandorisë Osmane, e cila në fund të shekullit XIX ishte në krizë të thellë të strukturave të saj administrative, por njëkohësisht edhe në përpjekje për reformim. Mehdi Frashëri e përfundoi arsimin e mesëm dhe më pas u pranua në Shkollën Perandorake të Administratës Civile (Mekteb-i Mülkiye-i Şahâne) në Stamboll, një ndër institucionet më prestigjioze të perandorisë për formimin e elitave burokratike. Ky institut ishte i njohur për programin e tij të përparuar në fusha si administrata publike, drejtësia, ekonomia politike, historia, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe filozofia politike. Ndërkohë që shumë shqiptarë të asaj kohe ndiqnin studime teologjike ose ushtarake, Mehdi Frashëri zgjodhi një formim më racional dhe modern, i cili do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në vizionin e tij mbi qeverisjen dhe shtetin. Përvoja e tij profesionale, pas diplomimit në Administratë Civile ("Mülkiye" - Mylkije), përfshinte një sërë postesh administrative në provinca të ndryshme të perandorisë, duke filluar nga Rodosi, Luleburgazi dhe më tej në Kudus (Jeruzalem), Kytahja (Kütahya) dhe Sjenicë. Për një kohë shumë të shkurtër, gati 11 muaj, Mehdi Frashëri ka qene Vali i Jerusalemit, e cila është detyra e fundit që ka mbajtur si funksionar i lartë osman. Këtë detyrë ai e braktisi për t'i shërbyer shtetit të ri shqiptar. Në këto pozicione, ai përballej me probleme komplekse të qeverisjes, në një kontekst shumetnik dhe me

larmi besimesh fetare. Mjediset e ndryshme administrative dhe sfidat që ato paraqisnin i ofruan Frashërit mundësinë për të zhvilluar një qasje të matur dhe gjithëpërfshirëse ndaj qeverisjes, duke i dhënë përparësi ligjit, racionalitetit dhe stabilitetit institucional. Pikërisht këto përvoja ndikuan në formimin e një botëkuptimi politik, ku qeverisja nuk bazohej në autoritarizëm arbitrar, por në profesionalizëm dhe shërbim ndaj interesit publik. Ai e kuptonte rëndësinë e një administrate të depolitizuar, të pavarur dhe të strukturuar në bazë të meritës, si kusht për zhvillim dhe përparim. Ky formim e bëri Mehdi Frashërin të ndryshëm nga shumë figura të tjera politike shqiptare të kohës, të cilët shpesh e shihnin shtetin si mjet përfitimi personal ose tributar ndaj interesave të ngushta krahinore apo ideologjike. Ai, përkundrazi, ishte përfaqësues i një elite që kishte kaluar nëpër filtrin e përvojës perandorake dhe që e shihte shtetin si një organizëm të ndërlikuar dhe të nevojshëm për mbrojtjen e së drejtës, të pronës dhe të identitetit kolektiv.

Roli në ndërtimin e shtetit shqiptar (1912–1939).

Pas shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912, Shqipëria u përball me një seri sfidash të mëdha që rrezikonin vetë ekzistencën e saj si shtet. Mungesa e një administrate të qëndrueshme dhe e një ushtrie kombëtare, kërcënimet e fqinjëve dhe ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha, e bënë procesin e shtetformimit një sipërmarrje tepër të brishtë. Në këtë kontekst historik, figura e Mehdi Frashërit doli në pah si një ndër ndërtuesit e rëndësishëm të institucioneve dhe të mendimit shtetformues shqiptar. Frashëri u përfshi në fillesat e organizimit shtetëror, që në vitet e para pas pavarësisë. Në vitin 1912 ai u caktua përfaqësues i qeverisë shqiptare pranë Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK) për Shqipërinë. Ai ishte pjesëmarrës në Kongresin e Durrësit (1918), i cili synonte të afirmonte një autoritet përfaqësues shqiptar, përballë diplomacisë ndërkombëtare, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Edhe pse ky kongres ishte i kritikuar për afërsinë e tij me fuqitë perëndimore, Frashëri punoi që brenda këtij realiteti politik t'i jepte formë një modeli institucional funksional dhe të ruante integritetin territorial të vendit. Ndërkohë, kontributi i tij kulmoi me pjesëmarrjen në Kongresin e Lushnjës, më 1920, një nga momentet kyçe të shtetformimit shqiptar. Si një nga figurat që gëzonte besimin e elitës politike dhe intelektuale, ai mbrojti idenë e një shteti të pavarur, me bazë kombëtare, i lirë nga ndikimi i huaj dhe me institucione përfaqësuese. Kongresi i Lushnjës nuk ishte vetëm një ngjarje politike, por edhe një pikë kthese në ndërtimin e themeleve kushtetuese dhe administrative të Shqipërisë. Frashëri kontribuoi në formulimin e strukturave të reja shtetërore: Këshillin Kombëtar, qeverinë e përkohshme dhe organizimin e ministrive, duke sjellë përvojën e tij nga administrata osmane dhe vizionin e tij për një shtet modern shqiptar.

Në periudhën e Monarkisë së Zogut (1925–1939), Mehdi Frashëri shërbeu në disa pozicione të rëndësishme qeveritare, përfshirë edhe postin e Kryeministrit të Shqipërisë, në vitin 1935, në një periudhë politike jashtëzakonisht të vështirë. Ai, gjithashtu, mbajti poste si Ministër i Jashtëm, Ministër i Ekonomisë, dhe anëtar i Këshillit të Shtetit. Në të gjitha këto funksione ai dëshmoi një përkushtim të rrallë ndaj ndërtimit të një administrate profesionale dhe joklienteliste. Ai përkrahu fuqishëm një sistem meritokratik në përzgjedhjen e nëpunësve, mbrojti transparencën dhe e

kritikoi haptazi korrupsionin në institucionet shtetërore. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i rolit të tij në këtë periudhë ishte mbrojtja e shtetit ligjor dhe kufizimi i autoritarizmit. Edhe pse kishte marrëdhënie bashkëpunimi me Mbretin Zog, Mehdi Frashëri nuk ngurroi të shprehte kritika ndaj tendencave absolutiste të pushtetit. Ai mbrojti rëndësinë e ndarjes së pushteteve, e parlamentit si institucion përfaqësues, si dhe e të drejtave individuale. Frashëri e shihte shtetin si një organizëm që duhej t'u shërbente qytetarëve dhe të ndërtohej mbi baza ligjore, jo si mjet për konsolidimin personal të pushtetit. Veprimtaria e tij gjatë kësaj periudhe përfshin, gjithashtu, përpjekje për zhvillimin ekonomik të vendit. Ai përkrahu nismat për investime në infrastrukturë, krijimin e bankave kombëtare, reformimin e sistemit fiskal dhe organizimin e ekonomisë bujqësore. Për më tepër, në fushën e arsimit dhe kulturës Mehdi Frashëri nxiti përhapjen e shkollave shqipe dhe forcimin e identitetit kombëtar, përmes edukimit modern. Në tërësi, roli i Mehdi Frashërit në ndërtimin e shtetit shqiptar ishte shumëdimensional: nga pjesëmarrja aktive në momentet kyçe të vendimmarrjes historike, deri tek hartimi dhe zbatimi i politikave administrative, ekonomike dhe arsimore. Ishte ai që hodhi bazat për hartimin e Kodit Penal, bazat që përdoren edhe në ditët e sotme. Ai përfaqësonte një mendësi teknokratike dhe institucionale e rrallë për kohën, që e shihte shtetin jo si përfitim, por si mision për të ardhmen e kombit shqiptar.

Mendimi politik dhe veprat intelektuale.

Mehdi Frashëri përfaqëson një nga mendimtarët më të strukturuar dhe të thelluar politikë të periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, në Shqipëri. Formimi i tij në administratën osmane dhe ekspozimi ndaj ideve perëndimore i dhanë mundësinë të ndërtojë një mendim politik të ekuilibruar midis real-politikës dhe aspiratave për një shtet demokratik dhe sundim të ligjit. Ai ishte pjesë e asaj elite shqiptare që e shihte shtetin si një organizëm racional, të ndërtuar mbi bazat e ligjit, arsimimit dhe meritokracisë, në një kohë kur shumë nga kundërshtarët e tij promovonin pushtetin personal dhe ideologjitë totalitare.

Në mendimin politik të Frashërit, shquhen disa shtylla kryesore:

- Shteti i së drejtës dhe qeverisja ligjore.

Frashëri ishte një mbrojtës i vendosur i shtetit ligjor. Ai besonte se pa një sistem juridik të drejtë dhe të zbatueshëm për të gjithë, shteti shqiptar nuk mund të funksiononte si një entitet i qëndrueshëm. Në tekstet e tij politike dhe veprat publicistike, ai theksonte rëndësinë e ndarjes së pushteteve, të drejtësisë së pavarur dhe të një administrate që i nënshtrohej ligjit e jo vullnetit të individëve të fuqishëm.

- Qëndrimi ndaj totalitarizmave: Antifashist dhe Antikomunist.

Një prej tipareve më të dallueshme të mendimit politik të Mehdi Frashërit ishte refuzimi i çdo forme të totalitarizmit. Ai shprehu kritika të hapura ndaj fashizmit italian dhe regjimit gjerman,

por njëkohësisht ishte një nga kundërshtarët më të ashpër të komunizmit, në radhët e elitës shqiptare. Ai e shihte fashizmin si një pushtet që shfrytëzonte ndjenjat nacionaliste për qëllime kolonizuese, ndërsa komunizmin si një sistem që shtypte individin, eliminonte pronën private dhe shkatërronte pluralizmin politik. Në këtë kuadër, veprat dhe mendimi i Frashërit paraqesin një pozicion unik: ai nuk përkrahu as “kampin fashist” dhe as atë “komunist”, duke mbetur i palëkundur në mbrojtjen e një Shqipërie të pavarur, pluraliste dhe me institucione funksionale. Kjo qasje e ka bërë atë një nga figurat më të debatueshme, por njëkohësisht më të vlerësueshme në reflektimet paskomuniste.

- Rëndësia e arsimit dhe elitarizmi i mendimit

Frashëri e konsideronte arsimin si mjetin më të fuqishëm për ndërtimin e një kombi të qëndrueshëm. Në shumë nga shkrimet e tij ai shpreh shqetësimin për mungesën e përgatitjes intelektuale të klasës politike shqiptare dhe nevojën për ngritjen e një elite të re, të arsimuar dhe të përkushtuar ndaj interesit publik. Ai nuk ishte populist, përkundrazi, kishte një qëndrim elitar ndaj politikës, duke besuar se drejtimi i shtetit kërkonte dije, përgatitje dhe përgjegjësi.

Vepra “Kujtime 1939–1945”.

Një burim tejet i rëndësishëm për të kuptuar mendimin dhe përjetimet politike të Frashërit është vepra e tij autobiografike “Kujtime 1939–1945”. Kjo vepër nuk është thjesht një rrëfim personal, por një analizë e thellë politike e ngjarjeve dramatike që kaloi Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore. Frashëri përpiqet të shpjegojë zgjedhjet e vështira politike që u detyrua të bënte, përfshirë pranimin për të udhëhequr një qeveri nën okupimin gjerman, me arsyetimin se kjo ishte një mënyrë për të shmangur ndarjen territoriale të Shqipërisë dhe për të mbrojtur një minimum autonomie kombëtare. Përmes analizave të tij në këtë vepër, ai përpiqet të rishkruajë historinë nga këndvështrimi i një njeriu që e vuan humbjen e idealit të Shqipërisë së pavarur dhe demokratike. Ai e shpreh qartë zhgënjimin nga humbja e elitës shqiptare dhe triumfi i forcave komuniste, të cilat i konsideronte si instrumente të një diktature ideologjike dhe antikombëtare. Gjatë karrierës së tij politike, Mehdi Frashëri arriti të botonte rreth 600 artikuj publicistikë e studimorë në gazeta e revista të ndryshme, si dhe libra siç ishin: “Koka e prerë e Ali Pashë Tepelenës”, “Tirana kryeqytet i Shqipërisë” e të tjerë.

Qëndrimi gjatë pushtimeve të huaja dhe dilemat e kohës

Gjatë periudhës 1939–1944, Shqipëria u gjend nën pushtime të njëpasnjëshme; fillimisht nga Italia fashiste dhe më pas nga Gjermania naziste. Elita politike shqiptare u përball me një seri dilemash ekzistenciale që kishin të bënin me mbijetesën e shtetit, integritetin territorial dhe ruajtjen e një minimumi autonomie përballë fuqive të huaja. Në këtë sfond të ndërlikuar historik Mehdi Frashëri zgjodhi të angazhohej në mënyrë aktive, duke marrë edhe përgjegjësi të larta shtetërore, në kushte okupimi. Në prill të vitit 1939, pikërisht më 7 prill, ditën kur u dha lajmi që

trupat ushtarake italiane kishin zbarkuar në Portin e Durrësit, Mehdi Bej Frashëri do të dilte të mbante një fjalim në Radio Tirana. Nëpërmjet këtij fjalimi ai do t'i drejtohej popullit shqiptar që të ngrihej kundër pushtuesit italian. Ky fjalim që do t'i kushtonte shtrenjtë Mehdi Beut, sepse pas këtij fjalimi ai do të internohej në Itali, në kampet e përqendrimit, vend ku do të qëndronte deri në vitin 1943.

Refuzimi i bashkëpunimit me pushtuesit italianë

Frashëri nuk pranoi të ishte pjesë e strukturave politike të krijuara nga pushtuesit italianë pas prillit 1939, duke dëshmuar një qëndrim të qartë kundër nënshtrimit të vendit ndaj Italisë fashiste. Ai e konsideronte pushtimin italian jo vetëm si një akt antikombëtar, por edhe si një prapambetje për të ardhmen e Shqipërisë. Në këtë periudhë, ai qëndroi jashtë jetës politike aktive, duke ruajtur një profil kritik dhe skeptik ndaj zhvillimeve që po ndodhnin në vend.

Angazhimi në qeveri, nën pushtimin gjerman.

Pas kapitullimit të Italisë në shtator 1943 dhe pushtimit të Shqipërisë nga Gjermania naziste, Mehdi Frashëri u ftua të merrte drejtimin e një qeverie shqiptare. Ishin autoritetet gjermane që me kërkesë të disa personaliteteve të kohës si Xhafer Deva, apo Bedri Pejani, ndërhyjnë tek autoritetet italiane për të sjellë në Tiranë Mehdi Bej Frashërin. Pas kërkesës së bërë nga autoritetet gjermane, në nëntor të vitit 1943, ai pranoi të kryesonte një kabinet, me bindjen se përfshirja e tij do të shërbente për të frenuar copëtimin e Shqipërisë dhe për të mbrojtur njëfarë autonomie kombëtare. Në këtë mënyrë ai u bë Kryetar i Këshillit të Lartë të Regjencës, e cila përbëhej nga Mehdi Frashëri, At Anton Harapi, Lef Nosi dhe Fuat Dibra. Në kujtimet e tij, Frashëri argumenton se vendimi për të pranuar këtë rol ishte një zgjedhje e vështirë dhe e detyruar nga rrethanat, një kompromis për të ruajtur interesin kombëtar. Ky vendim ka mbetur objekt debatesh të shumta në historiografinë shqiptare. Nga njëra anë, ai është kritikuar si akt bashkëpunimi me okupatorin; nga ana tjetër, në kontekstin e një Shqipërie të kërcënuar nga ndarja dhe në mungesë të alternativave reale, kjo zgjedhje paraqitet si një përpjekje pragmatike për të mbrojtur integritetin e vendit.

Politikat e qeverisë së tij dhe përpjekjet për ruajtjen e rendit.

Qeveria e drejtuar nga Frashëri u përpoq të vendoste njëfarë rendi institucional dhe të frenonte influencën e drejtpërdrejtë gjermane në administratën shqiptare. Ai nxiti ruajtjen e sovranitetit formal të institucioneve dhe nuk lejoi vendosjen e simbolikës naziste në institucionet shqiptare. Ndërkohë, u përpoq të pengonte rekrutimin e shqiptarëve në formacionet ushtarake gjermane dhe të evitonte ndonjë përplasje të drejtpërdrejtë me forcat partizane. Megjithatë me autoritet të kufizuar real, qeveria e tij synonte të krijonte një tampon institucional që të mbante larg vendimet e drejtpërdrejta të gjermanëve dhe të ruante kohezionin kombëtar në një kohë të shpërbërjes politike dhe ushtarake të rajonit.

Raportet me lëvizjet e tjera politike

Frashëri u përpoq të krijonte ura komunikimi edhe me përfaqësues të forcave të tjera politike shqiptare, përfshirë edhe individë nga Balli Kombëtar dhe Legaliteti. Ai nuk pati marrëdhënie me Frontin Nacionalçlirimtar, të cilin e konsideronte një lëvizje të dominuar nga komunistët dhe të drejtuar nga direktivat sovjetike. Ai paralajmëronte që, nëse kjo forcë do të merrte pushtetin, Shqipëria do të hynte në një epokë diktature ideologjike dhe izolimi ndërkombëtar.

Dorëheqja dhe mërgimi.

Frashëri u largua nga Shqipëria së bashku me gruan e tij Nejre Biçaku Frashëri dhe tre fëmijët Vehbiun (1906), Medihanë (1911) dhe Ragipin (1913), ndërkohë la pas të bijën Shehriarin (1907) e cila ishte e martuar. Ai u largua nga Tirana në nëntor 1944, shkoi në Shkodër, prej andej në Mal të Zi e Austri dhe përfundimisht u vendos në Itali, vend i cili ishte nën kontrollin e Forcave Aleate. Në Itali ai dhe familja e tij përfituan azil politik dhe me të mbërritur në Romë ata u vendosën në një apartament në Piazza “Regina Margherita”. Kjo shënoi fundin e angazhimit aktiv të tij në politikën shqiptare brenda vendit, por jo fundin e veprimtarisë së tij politike. Asokohe, në moshë të thyer, ai vendosi që t’i përkushtohej veprimtarisë studimore, ku nisi të shkruante një libër me titull “Historia e Shqipërisë”, por që mbeti në trajtë dorëshkrimi, pasi nuk mundi ta botonte.


Përndjekja.

Me ardhjen në pushtet të regjimit totalitar komunist, një pjesë e mirë e elitës drejtuese të vendit, si Patër Anton Harapi, Lef Nosi, Kolë Bib Mirakaj, Bahri Omari etj., u largua nga Shqipëria. Mehdi Frashëri nuk iku në një mënyrë të fshehtë apo të rrëmbyer, por si pjesë e tërheqjes së përgjithshme gjermane dhe strukturave që ata kishin ngritur në Shqipëri.

Siç u tha më lart, ai u largua nga Shqipëria së bashku me familjen e tij, gruan Nejre Biçaku Frashëri, dy djemtë Vehbiun dhe Ragipin, si dhe njërën prej vajzave, Medihanë. Vajza tjetër, Shehriari, që ishte e martuar me Remzi Çelon, tregtar nga Leskoviku, nuk pranoi të largohej nga Shqipëria së bashku me pjesën tjetër të familjes edhe pse e kishte të prerë biletën për t’u larguar.¹ Shehriari në atë periudhë ndodhej në Shqipëri për shkak të luftës civile që po zhvillohej në Greqi,

¹ Dashnor Kaloçi, “Gjyshi im, Mehdi bej Frashëri, ish-kryeministër, i ndihmonte komunistët, kurse ata tentuan ta vrisnin me atentat te shtëpia ku banonte me Dilot,” Memorie.al. <https://memorie.al/gjyshi-im-mehdi-bej-frasheri-ish-kryeminister-i-ndihmonte-komunistet-kurse-ata-tentuan-ta-vrisnin-me-atentat-te-shtepia-ku-banonte-me-dilo-t-deshmia-e-rralle-e-nipit-te-tij/?fbclid=IwAR16VCC-qkQckVWS8MjBIIWUiW9WJdX6akaD9rpDhmt2EQL3H-Ix82QcVZs>.

pasi familja e bashkëshortit të saj ishte një familje tregtare e pasur nga Leskoviku, por që jetonin në Selanik.



Deklaratë e Këshillit të Naltë të Regjencës, për largimi nga detyra të vetë Këshillit dhe të qeverisë shqiptare. më 26 tetor 1944.



SHTETI SHQIPTAR

KRYESIJA E KESHILLIT TË NALTË

Tiranë, me _____

29 38

Nr. _____

V E N D I M

Sot ditën e Djelës, me 15 Tetuer 1944, n'ora 10 para drekës, Këshilli Ministruer u mbledh pranë Selisë së Këshillit të Naltë, dhe u lexue shkresa e Der Befehlshaber der deutschen Truppen in Albanien me datë 14 Tetuer 1944 e firmueme prej Generalleutnant BAIER, ku shkurtimisht thuhet se :

1. Për shkakë ushtarake Komanda e Naltë mund të transferohet në një vend tjetër të Shqipërisë, dhe në këtë rast duhet që Këshilli i Naltë dhe Qeveria të shoqërojnë Komandën e Naltë Ushtarake Gjermane.
2. Përndryshej si Këshilli i Naltë ashtu dhe Qeveria duhet të na pin dorëheqjen.

Pas shumë bisedimevet ku muer pjesë si Kryeministri ashtu dhe Antarët e Kabinetit, më së fundi me vota të njajta u vendosë për mos transferimin e Qeverisë dhe largimin nga detyra kur Komanda e Naltë Gjermane do të transferohet në një vend tjetër.

Gjithashtu, dhe dy Antarët e tjerë të Këshillit të Naltë, veçanërisht muernë në bisedim po këto të dy pika, që propozohen prej Komandës Gjermane, ashtu dhe vendimin e sipërmë të Këshillit Ministruer, dhe vendosën pëlqimin e vendimit të Këshillit Ministruer në fjalë për mos transferimin e Qeverisë dhe largimin nga detyra kur Komanda e Naltë Gjermane do të transferohet në një vend tjetër.

KRYETARI I KESHILLIT TË NALTË : ANTARI I KESHILLIT TË NALTË :
(Mehdi Frashëri) : (Lef Nosi)

KRYEMINISTRI dhe Ministri i Drejtësisë : Ministri i Financave :
Zav. Ministër i P. Mbrendëshme : (Rrok Kolaj) (Et-hem Cara)
e Lav. për P. Jashtë : (Akile Tasi)
Ministri i Ekonomisë Kombëtare e (Akile Tasi)
Zav. Ministër i Punëve Botore :
(Refat Begolli)

Zav. Sekretar i Përgj. i Këshillit të Naltë :
Dr. Demir Vila
(Dr. Demir Vila)

Antarë operator për detyrë
Antarë operator për detyrë

Vendim i qeverisë shqiptare, i datës 15 tetor 1944, lidhur me moszbatimin e kërkesës së Komandës së Lartë Gjermane, për shoqërimin e saj, kur kjo e fundit të zhvendosej nga Tirana.

Ishte pikërisht kjo arsyeja pse ajo nuk pranoi të largohej me familjen atërore, sepse mendonte që me mbarimin e Luftës Civile në Greqi ajo do të rikthehej atje për të vazhduar jetën normalisht. Vitet e para pas largimit të të atit, Shehriari dhe familja e saj nuk do të kishin probleme me regjimin e ri. Në vitin 1953 ishte viti në të cilin atyre iu kërkua që të largoheshin nga shtëpia e tyre në Qytetin Studenti, - një vilë të cilën e kishte ndërtuar me kredi vetë Mehdi Frashëri, - për t'ia liruar shtëpinë njërit prej funksionarëve të kohës dhe vetë të shpërnguleshin në shtëpinë e këtij të fundit, që ndodhej në Brrakë. Për shkak të gjendjes së rënduar të shtëpisë dhe kushteve të rënduara atmosferike, shtëpia u shemb dhe Remzi Çelo nuk pranoi që të firmoste ndërrimin e shtëpive. Refuzimi bëri që autoritetet e kohës të nxirrnin një urdhër sekuestrimi të vilës dhe transferimin e familjes në Durrës, ku qëndruan për tre vite. Pas kësaj nate do të fillonte edhe kalvari i vuajtjeve të vajzës së Mehdi Frashërit, familja e së cilës jetoi në internim për 33 vite me radhë, në kampet e Gradishtës, Savrës, Kuçit etj.



Mehdi Frashëri me bashkëshorten, Neire Bicaku Frashëri, në fillimet e karrierës së tij.




Shehriar Frashëri Çelo, e bija e Mehdi Frashërit, në internim në Savër të Lushnjës.

Gjatë periudhës që ishte në mërgim, Mehdi Frashëri ka qenë nën vëzhgim gjatë gjithë kohës, siç kuptohet nga informatat e ndryshme që gjenden në dosjen e tij. Nëpërmjet këtyre informatave, pushteti i asaj periudhe vihej në dijeni mbi lëvizjet që ai bënte, si dhe takimet që bënte me intelektualët e tjerë shqiptarë që ishin në mërgim, me në krye Ahmet Zogun. Informatat përmbanin kryesisht vendtakimin, pjesëmarrësit në takim, pikat që diskutoheshin dhe vendimet që merreshin gjatë takimit. Shtypi i kohës do ta etiketonte Mehdi Frashërin si një tradhtar që shiti popullin e vet për para dhe kolltuk. Në shtypin e kohës, internimi tij në Itali përcillej sikur ishte dërguar atje për qëllime të paracaktuara politike, madje shkruhej se atje ai jetonte në pallatet dhe hotelet më të mira dhe që merrte rrogë të majme nga qeveria Italiane. Në shtyp, gjithashtu, flitej edhe për bashkëpunimin e tij me gjermanët, për të krijuar qeverinë kuinslinge, me të cilët bashkëpunoi edhe për masakrën e fshatit Borovë të Korçës. Akuzë tjetër ishte se ai, gjithashtu, urdhëroi edhe shtypjen e të gjitha çetave partizane, si edhe internimin e tyre në Kampin e Prishtinës. Një tjetër akuzë në emër të tij lidhet edhe me bashkëpunimin me qeverinë greke, për nënshkrimin e një marrëveshje, ku në pikën 7 të së cilës shkruhej: “Në rast lufte, Komanda e Përgjithshme Ushtarake do të vihet në dorën e Greqisë”. Këtë marrëveshje do ta nënshkruante Dhimitër Follo, i cili ishte i dërguari i Mehdi Frashërit; Xhavit Leskoviku, nga qeveria kuinslinge e Tiranës; Koço Kota; nga partia Zogiste dhe Selim Rizaja si përfaqësues i Kosovës. Por kjo marrëveshje nuk u arrit që të përfundohej, pasi Dhimitër Follo u kap dhe u ekzekutua nga forcat nacional-çlirimtare, dhe ishte pikërisht ai që e kishte dokumentin i cili do të nënshkruhej. Ishin këto disa nga akuzat e pabaza që bëheshin ndaj Mehdi Frashërit dhe askund nuk përmendej përpjekja që ai bëri për mbrojtjen dhe shpëtimin e hebrenjve nga kthetrat e gjermanëve, duke treguar jo vetëm mikpritjen dhe besën e shqiptarit, por edhe për shkak të faktit që, - siç thotë ish-ambasadori OSBE-së në Shqipëri, gjermani Bernd Borhard, në një intervistë për radion Dojçe Vele (Deutsche Welle) - “...në shtatorin e vitit 1943, gjatë një takimi mes përfaqësuesve të lartë

të Gestapos dhe Ministrisë së Jashtme Gjermane ishte marrë vendimi që Shqipërisë të mos i bëhej presion për deportimin e hebrenjve, sepse shpresonin që Shqipëria të mbetej vend besnik”.²

Në maj të vitit 1963 do të vinte informata e cila do të njoftonte vdekjen e Mehdi Frashërit. Ai mbylli sytë për herë të fundit në shtëpinë e tij në Romë, më 25 maj të vitit 1963 dhe varrimi i tij



Informata e dërguar për njoftimin e vdekjes dhe varrimit të Mehdi Frashërit në maj 1963.

u bë më 29 maj 1963.

Aktiviteti në mërgatë dhe rezistenca politike.

Pas vitit 1944, me instalimin në Shqipëri të regjimit komunist, Mehdi Frashëri, i njohur si një prej figurave më të rëndësishme të nacionalizmit shqiptar, u detyrua të largohej nga vendi dhe të vendosej përfundimisht në Itali. Ai nuk u largua nga veprimtaria politike, por përkundrazi vazhdoi të punonte me intensitet për çështjen shqiptare edhe në mërgatë, duke u përpjekur të mbante të gjallë frymën e rezistencës ndaj komunizmit. Në diasporë Frashëri u bë një nga organizatorët kryesorë të rezistencës politike shqiptare jashtë vendit. Ai ishte një nga figurat udhëheqëse të “Bllokut Kombëtar Indipendent”, një organizatë e emigracionit politik që kishte për synim rrëzimin e regjimit komunist dhe rikthimin e demokracisë në Shqipëri. Veprimtaria e tij përfshinte krijimin e kontakteve me qarqe perëndimore, shkrimin e artikujve dhe të memorandumëve politike, si dhe organizimin e emigrantëve shqiptarë, për të përçuar mesazhin e lirisë dhe të rrezikut të izolimit që i kanosej vendit nën diktaturën komuniste. Frashëri e kuptonte qartë rrezikun që paraqiste izolimi ideologjik i Shqipërisë, nën regjimin e Enver Hoxhës. Ai parashikonte se politika e mbylljes, e ndikuar nga komunizmi stalinist, do ta largonte Shqipërinë nga zhvillimet demokratike të Evropës dhe do ta shndërronte në një vend të izoluar, të varfër dhe të shtypur. Për këtë arsye, ai përdori të gjitha mjetet diplomatike dhe publicistike për të alarmuar Perëndimin mbi gjendjen në Shqipëri, duke synuar që Shqipëria të mos harrohej nga politika ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe, Frashëri bashkëpunoi me shumë personalitete të mërgatës shqiptare, si dhe me përfaqësues të vendeve aleate, për të ndihmuar në ndërtimin e një opozite të

² “Si i shpëtuan shqiptarët hebrenjtë, ish-ambasadori gjerman në Tiranë tregon për dokumentet që ka parë në arkiva,” Veriu Info, 27 janar 2024, <https://veriu.info/si-i-shpetuan-shqiptaret-hebrenjte-ish-ambasadori-gjerman-ne-tirane-tregon-per-dokumentet-qe-ka-pare-ne-arkiva/>.

organizuar jashtë vendit. Aktiviteti i tij ishte i një rëndësie të veçantë për ruajtjen e vetëdijes kombëtare dhe të përpjekjeve për një Shqipëri të lirë, demokratike dhe të hapur ndaj botës. Në këtë kontekst, veprimtaria e Mehdi Frashërit në mërgatë, pas vitit 1944, përfaqëson një nga shembujt më domethënës të rezistencës politike shqiptare jashtë vendit, ku angazhimi intelektual, diplomatik dhe atdhetar u bë armë kundër diktaturës dhe izolimit

Vepra autobiografike dhe rëndësia e tyre për historiografinë.

Vepra “Kujtime 1939–1945” zë një vend të veçantë jo vetëm në krijimtarinë e Mehdi Frashërit, por edhe në historiografinë shqiptare, pasi përbën një prej dëshmive të rralla të shkruara nga brenda elitës politike shqiptare të periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Në këtë vepër me karakter autobiografik, Frashëri nuk kufizohet thjesht në rrëfimin personal, por ofron një pasqyrë të gjerë analitike mbi zhvillimet politike, ushtarake e shoqërore që çuan në kolapsin e shtetit shqiptar, pushtimin italian dhe gjerman, si dhe përpjekjet për mbijetesë të elitës së kohës. Duke mbrojtur qëndrimet dhe vendimet e veta politike, autori krijon një korrigjim ndaj narrativës zyrtare komuniste, duke sjellë argumente nga përvoja e tij si diplomat, politikan dhe mendimtar. Ajo që e bën këtë vepër të çmuar për studiuesit është fakti që, përveç kronikës së ngjarjeve, Frashëri zhvillon reflektime të thella filozofike mbi fatin historik të Shqipërisë, krizën e elitës dhe pengesat në ndërtimin e një shteti modern perëndimor. Ai trajton me vetëdije kritike çështje të tilla si mungesa e institucioneve të konsoliduara, raporti midis patriotizmit dhe interesave personale, roli i ndërhyrjeve të huaja dhe sfidën e formimit të një ndërgjegjeje qytetare. “Kujtime 1939–1945” shquhet kështu si një dokument historik me rëndësi të shumëfishtë: burim i dorës së parë për të kuptuar botën politike shqiptare të kohës; dëshmi e pozicionit antikomunist të Frashërit dhe, mbi të gjitha, si një përpjekje intelektuale për të ofruar një autopsi të shtetit shqiptar në momentet e tij më të vështira, duke lënë pas një trashëgimi mendimi me vlerë të madhe për historianët dhe studiuesit e politikës së kombit shqiptar.

Kujtesa historike dhe debatet në periudhën paskomuniste.

Gjatë periudhës së regjimit komunist, figura e Mehdi Frashërit u stigmatizua dhe u përfshi në listën e “armiqve të popullit”, duke u paraqitur në tekstet zyrtare si tradhtar, kolaboracionist dhe përfaqësues i “reaksionit borgjez”. Kjo qasje e planifikuar propagandistike synoi zhdukjen e kontributit të tij nga kujtesa kolektive dhe përjashtimin e tij nga panteoni i figurave kombëtare. Pas rënies së komunizmit, në vitet 1990, procesi i demokratizimit solli një rishqyrtim të figurave historike të anatemuara nga regjimi, duke hapur një debat të gjerë publik e akademik mbi rolin real të Frashërit në historinë shqiptare. Rehabilitimi i tij ka shënuar një kthesë të rëndësishme në procesin e rishkrimit të historiografisë kombëtare. Studiues, institucione shkencore dhe media, kanë theksuar nevojën për ta parë Mehdi Frashërin si një figurë komplekse historike - një intelektual me formim evropian, i angazhuar për modernizimin e Shqipërisë dhe ndërtimin e një shteti perëndimor të orientuar drejt demokracisë liberale. Në tekstet bashkëkohore shkollore ai nuk paraqitet më si një figurë negative, por si një mendje e hapur dhe vizionar, i cili mbrojt

identitetin kombëtar, lirinë politike dhe vlerat evropiane, në kushtet e krizës së thellë të shtetit shqiptar.

Ky riinterpretim i rolit të tij përbën një kundërpeshë të rëndësishme ndaj narrativave totalitare, duke nxitur debat mbi shumëkuptimësinë e historisë, rolin e elitave dhe paaftësinë e versioneve moniste për të shpjeguar të kaluarën. Përmes këtij procesi, Mehdi Frashëri është rikthyer në qendër të kujtesës historike, si një prej figurave që mishërojnë përpjekjen për një Shqipëri moderne e të hapur ndaj botës.

Përfundime dhe perspektiva

- Figura e Mehdi Frashërit mbetet një nga çelësat interpretues për të kuptuar transformimet e identitetit shtetëror dhe politik shqiptar, nga fundi i Perandorisë Osmane, deri tek emigracioni politik, pas Luftës së Dytë Botërore.
- Rruga e tij jetësore pasqyron evolucionin dhe sfidat e elitës shqiptare, e cila u përball me detyrën e ndërtimit të një shteti modern, në kushte të jashtëzakonshme presioni të brendshëm dhe ndërkombëtar.
- Mehdi Frashëri përfaqëson një brez politikanësh me formim juridik, institucional dhe kombëtar, të cilët e shihnin shtetin ligjor si bazë të zhvillimit dhe konsolidimit të shtetësisë shqiptare.
- Rrethanat historike, shpesh të turbullta dhe të paparashikueshme, kërkuan kompromis dhe pragmatizëm politik. Ky realitet e ka bërë figurën e tij të debatuar, duke reflektuar tensionin mes idealeve të deklaruara dhe veprimeve të domosdoshme taktike.
- Pikërisht ky dyzim mes idealizmit dhe real-politikës e bën Frashërin një objekt studimi të rëndësishëm, për të kuptuar mënyrën sesi elitat shqiptare iu përgjigjën krizave; nga shpërbërja e Perandorisë Osmane, tek pushtimet e huaja dhe kërcënimet e komunizmit.
- Studimi i figurës së Mehdi Frashërit ndihmon në riformulimin e historiografisë shqiptare, duke theksuar nevojën e një qasjeje pluraliste, ku vendimet politike vlerësohen brenda kontekstit të kohës dhe jo nëpërmjet gjykimeve ideologjike të mëvonshme.
- Përmes figurës së tij del në pah kompleksiteti i proceseve historike shqiptare dhe sfida për të ndërthurur vizionin për modernitetin, me kufizimet strukturore dhe realitetet gjeopolitike.
- Mehdi Frashëri shërben si një lente analitike për të parë tranzicionet shqiptare, jo vetëm si thyerje të dhunshme, por edhe si procese të vazhdueshme negociimi midis vlerave, interesit kombëtar dhe faktorëve ndërkombëtarë.
- Perspektivat e ardhshme kërkimore mbi figurën e tij mund të kontribuojnë në ndërtimin e një narrative më të ekuilibruar, gjithëpërfshirëse dhe analitike të historisë shqiptare të shekullit XX.

Bibliografia

- Literatura

1. “Artikuj të mërgatës shqiptare.” *Shëjzat*, Romë (1957-1963).
2. Bello, Hasan. *Elita shqiptare e kohës së Mbretërisë (1928–1939)*. Tiranë: Instituti i Historisë, 2009.
2. Clayer, Nathalie. *Aux origines du nationalisme albanais*. Paris : Karthala, 2007.
3. Duka, Valentina. *Histori e Shqipërisë 1912–2000*. Tiranë: Kristalina KH, 2007.
4. Fischer, Bernd J. *Shqipëria gjetkë: Një histori politike*. Tiranë: Dituria, 2004.
5. Frashëri, Mehdi. *Kujtime 1939–1945*. Tiranë: Onufri, 2005.
6. Kressing, Frank, and Karl Kaser. *Albanian Identities: Myth and History*. London: Hurst, 2002.
7. Puto, Arben. *Lufta politike në Shqipëri 1943–1945*. Tiranë: Toena, 2006.
8. Qafoku, Roland. *100 politikanët më të shquar shqiptarë*. Tiranë: Onufri, 2015.
9. Tarifa, Fatos. *Elita intelektuale dhe tranzicioni shqiptar*. Tiranë: Dituria, 2002.

- Materiale arkivorë

Dosje Biografike për Mehdi Frashërin, Arkivi Qendror i Shtetit.

- Webfaqe

1. Kaloçi, Dashnor. “Gjyshi im, Mehdi bej Frashëri, ish-kryeministër, i ndihmonte komunistët, kurse ata tentuan ta vrisnin me atentat te shtëpia ku banonte me Dilo-t.” *Memorie.al*. <https://memorie.al/gjyshi-im-mehdi-bej-frasheri-ish-kryeminister-i-ndihmonte-komunistet-kurse-ata-tentuan-ta-vrisnin-me-atentat-te-shtepia-ku-banonte-me-dilo-t-deshmia-e-rralle-e-nipit-te-tij/?fbclid=IwAR16VCC-qkQckVWS8MjBliWUiW9WJdX6akaD9rpDhmt2EQL3H-Ix82QcVZs>.
2. Veriu Info. “Si i shpëtuan shqiptarët hebrenjtë, ish-ambasadori gjerman në Tiranë tregon për dokumentet që ka parë në arkiva,” 27 janar 2024. <https://veriu.info/si-i-shpetuan-shqiptaret-hebrenjte-ish-ambasadori-gjerman-ne-tirane-tregon-per-dokumentet-qe-ka-pare-ne-arkiva/>.
3. Dritare TV. “E vërteta e panjohur për Mehdi Frashërin. Flet stërnipi i tij! | Dekalog nga Roland Qafoku,” 28 korrik 2025. <https://www.youtube.com/watch?v=cMOco6NhxjQ>.